



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN  
MBI DOKUMENTET E ISH  
SIGURIMIT TË SHETIT**

**UNIVERSITETI I TIRANËS**

Nr. 192 Prot., Datë 8 / 3 /2018

Nr. 1172 Prot., Datë 8 / 3 /2018

### **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (më poshtë AIDSSH),**  
përfaqësuar nga **Kryetarja, Znj. Gentiana Sula;**

dhe

**Universiteti i Tiranës (më poshtë UT),** përfaqësuar nga **Rektori i Universitetit të Tiranës, Prof.  
Dr. Mynyr Koni;**

Nisur prej interesit të përbashkët të dy Institucioneve, palët bien dakord të lidhin këtë **Marrëveshje  
Bashkëpunimi** (më poshtë “**Marrëveshja**”).

#### **Neni 1**

#### **Objekti dhe qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është vendosja e urave të bashkëpunimit në fushën akademike si dhe për të kontribuar në procesin e formimit profesional të studentëve dhe pegagogëve, me fokus të veçantë të drejtat e njeriut dhe fuqizimin e shtetit të së drejtës.

Bashkëpunimi institucional ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Universitetit të Tiranës ka për objekt:

- Vendosjen e një bashkëpunimi afatgjatë dhe të frytshëm në kuadrin e praktikës mësimore, kërkimit shkencor, hartimit dhe zbatimit të projekteve të përbashkëta në përputhje me misionin dhe fushën e përgjegjësisë të të dy palëve.

- Angazhimin e studentëve dhe pedegagogëve të Fakultetit të Drejtësisë, Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, të Universitetit të Tiranës, në studime, monitorime dhe veprimtari të tjera ndërgjegjësuere dhe trajnuese të organizuara nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;
- Angazhimin e studentëve që studiojnë në Fakultetin e Drejtësisë, Fakultetin e Shkencave Sociale dhe në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës në praktika mësimore me kohëzgjatje të caktuar pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;

## **Neni 2**

### **Baza ligjore**

Baza ligjore e kësaj **Marrëveshje** është Ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, neni 17 i Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me Vendimin nr.21, datë 09.05.2014 të Autoritetit dhe Ligji nr. 85/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

## **Neni 3**

### **Sfera e bashkëpunimit**

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Universiteti i Tiranës angazhohen të bashkëpunojnë për:

- Hartimin e planeve të përbashkëta vjetore të aktiviteteve, konferencave, workshop, etj., në funksion të veprimtarisë hulumtuese dhe kërkimit shkencor, me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit apo të edukimit qytetar.
- Realizimin e projekteve të përbashkëta në fushën e të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe drejtësisë, historisë dhe shkencave sociale.
- Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta si forume, seminare, trajnime, duke inkurajuar organizimin e tyre në ambientet e Fakulteteve të Universitetit të Tiranës.
- Përzgjedhjen e studentëve që do të kryejnë praktikën mësimore.

## **Neni 4**

### **Detyrimet e Palëve**

Universiteti i Tiranës merr përsipër:

- Të identifikojë studentë të dalluar nga pikëpamja e përgatitjes dhe formimit dhe t’ja propozojë AIDSSH-së, bazuar në kërkesën e këtij të fundit, për t’u angazhuar në veprimtari të ndryshme monitoruese, ndërgjegjësuere dhe trajnuese.
- Të identifikojë pedagogë të interesuar, me përgatitje të dalluar në fushën e mësimdhënies dhe sipas fushës dhe ekspertizës së tyre dhe t’ja propozojë AIDSSH-së, bazuar në kërkesën

e këtij të fundit, për t'u angazhuar në veprimtari studiuuese, analizuuese, trajnuuese, ofrimin të shërbimeve ligjore, etj.

- Të njoftojë studentët për mundësitë e zhvillimit të praktikës mësimore me kohëzgjatje 1-4 mujore, pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.
- Të promovojë, sipas mundësisë, në aktivitetet që organizon dhe/apo merr pjesë bashkëpunimin me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.
- T'i dhurojë bibliotekës së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit një kopje të botimeve të saj, në masën që kjo është e mundur për Universitetin e Tiranës dhe Fakultetin të Drejtësisë, Fakultetin të Shkencave Sociale dhe Fakultetin të Historisë dhe Filologjisë.
- Të kontribuojë me literaturë dhe burime njerëzore, kur krijohet mundësia, për kërkimet dhe studimet e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në fushën e drejtësisë, shtetit të së drejtës, historisë dhe shkencave sociale .

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit merr përsipër:

- Të bashkëpunojë me Universitetin e Tiranës për hartimin e planeve të përbashkëta vjetore të aktiviteteve, konferencave, workshop, etj., me objekt rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit apo të edukimit qytetar ;
- T'i krijojë mundësi studentëve të Fakulteteve të Universitetit të Tiranës të kryejnë praktikën mësimore me kohëzgjatje 1- 4 mujore pranë AIDSSH-së. Praktika mësimore do të jetë pa pagesë. Numri i studentëve që kryejnë praktikën mësimore do të kufizohet në varësi të nevojave dhe mundësisë së stafit të AIDSSH-së që do të monitorojë praktikën.
- Të përpilojë një raport përshkrues dhe vlerësues për punën dhe sjelljen e studentit gjatë periudhës së praktikës mësimore pranë Drejtorive/Sektorëve të AIDSSH-së.
- Të promovojë, sipas mundësisë, në aktivitetet që organizon dhe/apo merr pjesë bashkëpunimin me Universitetin e Tiranës dhe Fakultetin të Drejtësisë, Fakultetin të Shkencave Sociale dhe Fakultetin të Historisë dhe Filologjisë.
- T'i dhurojë bibliotekës së Universitetit të Tiranës një kopje të botimeve të saj, në masën që kjo është e mundur për Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.
- Të kontribuojë me literaturë, kur krijohet mundësia, për kërkimet dhe studimet e Fakulteteve të Universitetit të Tiranës në fushat relevante me veprimtarinë e Autoritetit, konform nenit 36 dhe 37 të ligjit nr.45/2015.

## Neni 5

### Koordinimi ndërmjet palëve

1. Në zbatim të kësaj **Marrëveshje, AIDSSH dhe UT** do të caktojnë nga një person kontakti. Universiteti i Tiranës si palë e Marrëveshjes së Bashkëpunimit do të ketë personin e tij të kontaktit që do të komunikojnë me **AIDSSH**.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në varësi të nevojës për marrje dhe dhënie të informacioni dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshje.
3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përjashtuar format me të shpejta të komunikimit elektronik.
4. Palët do të njoftojnë reciprokisht në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

**Neni 6**  
**Përmirësimet, Ndryshimet, Shtesat**

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe/apo shtesa në këtë **Marrëveshje**, bazuar në pëlqimin e ndërsjellë të tyre.
2. Çdo përmirësim, ndryshim dhe/apo shtesë do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e **AIDSSH** dhe **UT**, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.

**Neni 7**  
**Mirëbesimi**

1. **AIDSSH** dhe **UT** do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
2. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim dhe të përdorin sipas fushës së veprimit të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë **Marrëveshje**.

**Neni 8**  
**Afati i marrëveshjes**

1. Kjo **Marrëveshje** do të lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. **Marrëveshja** mund të përfundojë nga secila **Palë** nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim **Palës** tjetër, (të paktën një muaj përpara).
3. Në rast të përfundimit të kësaj **Marrëveshje**, palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo **Marrëveshje**, përsa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj.

**Neni 9**  
**Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo **Marrëveshje** hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. **Marrëveshja** është hartuar në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në **Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit** dhe dy të tjera në **Universitetin e Tiranës**.

**Për**

**Autoritetin për Informimin mbi  
Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit**

**KRYETARE**

Z. Gentiana SULA



**Për**

**Universitetin e Tiranës**

**REKTORI**

Dr. Myrteza KONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN  
MBI DOKUMENTET E ISH  
SIGURIMIT TË SHETIT**

**UNIVERSITETI I TIRANËS**

Nr. 192 Prot., Datë 8 / 3 /2018

Nr. 1172 Prot., Datë 8 / 3 /2018

### **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (më poshtë AIDSSH),**  
përfaqësuar nga **Kryetarja, Znj. Gentiana Sula;**

dhe

**Universiteti i Tiranës (më poshtë UT),** përfaqësuar nga **Rektori i Universitetit të Tiranës, Prof.**  
**Dr. Mynyr Koni;**

Nisur prej interesit të përbashkët të dy Institucioneve, palët bien dakord të lidhin këtë **Marrëveshje**  
**Bashkëpunimi** (më poshtë “Marrëveshja”).

#### **Neni 1**

#### **Objekti dhe qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është vendosja e urave të bashkëpunimit në fushën akademike si dhe për të kontribuar në procesin e formimit profesional të studentëve dhe pegagogëve, me fokus të veçantë të drejtat e njeriut dhe fuqizimin e shtetit të së drejtës.

Bashkëpunimi institucional ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Universitetit të Tiranës ka për objekt:

- Vendosjen e një bashkëpunimi afatgjatë dhe të frytshëm në kuadrin e praktikës mësimore, kërkimit shkencor, hartimit dhe zbatimit të projekteve të përbashkëta në përputhje me misionin dhe fushën e përgjegjësisë të të dy palëve.

- Angazhimin e studentëve dhe pedegagogëve të Fakultetit të Drejtësisë, Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, të Universitetit të Tiranës, në studime, monitorime dhe veprimtari të tjera ndërgjegjësuere dhe trajnuese të organizuara nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;
- Angazhimin e studentëve që studiojnë në Fakultetin e Drejtësisë, Fakultetin e Shkencave Sociale dhe në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës në praktika mësimore me kohëzgjatje të caktuar pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;

## **Neni 2**

### **Baza ligjore**

Baza ligjore e kësaj **Marrëveshje** është Ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, neni 17 i Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me Vendimin nr.21, datë 09.05.2014 të Autoritetit dhe Ligji nr. 85/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

## **Neni 3**

### **Sfera e bashkëpunimit**

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Universiteti i Tiranës angazhohen të bashkëpunojnë për:

- Hartimin e planeve të përbashkëta vjetore të aktiviteteve, konferencave, workshop, etj., në funksion të veprimtarisë hulumtuese dhe kërkimit shkencor, me qëllim rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit apo të edukimit qytetar.
- Realizimin e projekteve të përbashkëta në fushën e të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe drejtësisë, historisë dhe shkencave sociale.
- Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta si forume, seminare, trajnime, duke inkurajuar organizimin e tyre në ambientet e Fakulteteve të Universitetit të Tiranës.
- Përzgjedhjen e studentëve që do të kryejnë praktikën mësimore.

## **Neni 4**

### **Detyrimet e Palëve**

Universiteti i Tiranës merr përsipër:

- Të identifikojë studentë të dalluar nga pikëpamja e përgatitjes dhe formimit dhe t’ja propozojë AIDSSH-së, bazuar në kërkesën e këtij të fundit, për t’u angazhuar në veprimtari të ndryshme monitoruese, ndërgjegjësuere dhe trajnuese.
- Të identifikojë pedagogë të interesuar, me përgatitje të dalluar në fushën e mësimdhënies dhe sipas fushës dhe ekspertizës së tyre dhe t’ja propozojë AIDSSH-së, bazuar në kërkesën

e këtij të fundit, për t'u angazhuar në veprimtari studiuuese, analizuuese, trajnuuese, ofrimit të shërbimeve ligjore, etj.

- Të njoftojë studentët për mundësitë e zhvillimit të praktikës mësimore me kohëzgjatje 1-4 mujore, pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.
- Të promovojë, sipas mundësisë, në aktivitetet që organizon dhe/apo merr pjesë bashkëpunimin me Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.
- T'i dhurojë bibliotekës së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit një kopje të botimeve të saj, në masën që kjo është e mundur për Universitetin e Tiranës dhe Fakultetit të Drejtësisë, Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë.
- Të kontribuojë me literaturë dhe burime njerëzore, kur krijohet mundësia, për kërkimet dhe studimet e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në fushën e drejtësisë, shtetit të së drejtës, historisë dhe shkencave sociale .

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit merr përsipër:

- Të bashkëpunojë me Universitetin e Tiranës për hartimin e planeve të përbashkëta vjetore të aktiviteteve, konferencave, workshop, etj., me objekt rishqyrtimin historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit apo të edukimit qytetar ;
- T'i krijojë mundësi studentëve të Fakulteteve të Universitetit të Tiranës të kryejnë praktikën mësimore me kohëzgjatje 1- 4 mujore pranë AIDSSH-së. Praktika mësimore do të jetë pa pagesë. Numri i studentëve që kryejnë praktikën mësimore do të kufizohet në varësi të nevojave dhe mundësisë së stafit të AIDSSH-së që do të monitorojë praktikën.
- Të përpilojë një raport përshkrues dhe vlerësues për punën dhe sjelljen e studentit gjatë periudhës së praktikës mësimore pranë Drejtorive/Sektorëve të AIDSSH-së.
- Të promovojë, sipas mundësisë, në aktivitetet që organizon dhe/apo merr pjesë bashkëpunimin me Universitetin e Tiranës dhe Fakultetit të Drejtësisë, Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë.
- T'i dhurojë bibliotekës së Universitetit të Tiranës një kopje të botimeve të saj, në masën që kjo është e mundur për Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.
- Të kontribuojë me literaturë, kur krijohet mundësia, për kërkimet dhe studimet e Fakulteteve të Universitetit të Tiranës në fushat relevante me veprimtarinë e Autoritetit, konform nenit 36 dhe 37 të ligjit nr.45/2015.

## Neni 5

### Koordinimi ndërmjet palëve

1. Në zbatim të kësaj **Marrëveshje, AIDSSH dhe UT** do të caktojnë nga një person kontakti. Universiteti i Tiranës si palë e Marrëveshjes së Bashkëpunimit do të ketë personin e tij të kontaktit që do të komunikojnë me **AIDSSH**.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në varësi të nevojës për marrje dhe dhënie të informacioni dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshje.
3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përjashtuar format me të shpejta të komunikimit elektronik.
4. Palët do të njoftojnë reciprokisht në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

**Neni 6**  
**Përmirësimet, Ndryshimet, Shtesat**

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe/apo shtesa në këtë **Marrëveshje**, bazuar në pëlqimin e ndërsjellë të tyre.
2. Çdo përmirësim, ndryshim dhe/apo shtesë do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e **AIDSSH** dhe **UT**, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.

**Neni 7**  
**Mirëbesimi**

1. **AIDSSH** dhe **UT** do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
2. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim dhe të përdorin sipas fushës së veprimit të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë **Marrëveshje**.

**Neni 8**  
**Afati i marrëveshjes**

1. Kjo **Marrëveshje** do të lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. **Marrëveshja** mund të përfundojë nga secila **Palë** nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim **Palës** tjetër, (të paktën një muaj përpara).
3. Në rast të përfundimit të kësaj **Marrëveshje**, palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo **Marrëveshje**, përsa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj.

**Neni 9**  
**Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo **Marrëveshje** hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. **Marrëveshja** është hartuar në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në **Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit** dhe dy të tjera në **Universitetin e Tiranës**.

**Për**

**Autoritetin për Informimin mbi  
Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit**

**KRYETARË**

Znj. **Gentiana SULA**



**Për**

**Universitetin e Tiranës**

**REKTORI**

Dr. **Mynyr KONA**

